



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:296225

Datë: 06.04.2020

Numri i dokumentit: 00903145

A.nr. 3090/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative me gjyqtaren Arjeta Sadiku, në konfliktin administrativ të paditësit, Sami Kurteshi, me adresë në Rr."Xhavit Ahmeti", nr.9/A, Prishtinë, përfaqësuar me autorizim nga Getoar Mjeku, me adresë në Rr. "Enver Maloku", nr.110, Prishtinë, kundër të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës në Prishtinë, si dhe me palët me interes juridik, VBS SH.P.K., VITA ENERGY SH.P.K., ABRAZEN L.L.C., ENERGY DEVELOPMENT GROUP KOSOVA SH.PK., SOLAR GATE L.L.C., dhe Alsi & CO-Kosovë L.L.C. sh.p.k., përfaqësuar me autorizim nga Faton Qirezi dhe Alban Makolli, avokatë në Prishtinë, me bazë juridike; anulim i vendimit dhe me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të të njëjtit, jashtë seancës, duke vendosur lidhur me kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, me datën 6 prill 2020, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar** kërkesa për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, e parashtruar nga paditësi Sami Kurteshi nga Prishtina.
- II. SHTYHET** ekzekutimi i Vendimit të të paditurës, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRrE) e Republikës së Kosovës në Prishtinë, V_1204_2019 i datës 27 nëntor 2019, deri në vendimin definitiv gjyqësor sipas padisë.

A r s y e t i m i

Me datën 24 dhjetor 2019, paditësi Sami Kurteshi, përmes përfaqësuesit me autorizim, ka parashtruar padi në këtë gjykatë, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës ZRrE në Prishtinë, V_1204_2019 i datës 27 nëntor 2019. Paditësi gjithashtu i ka propozuar gjykatës shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të lartcekur, deri në vendosjen e çështjes kontestuese në mënyrë meritore.

Për të vlerësuar kërkesën e paditësit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, gjykata iu referua nenit 22 par. 2 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) i cili përcakton se:

“Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar”.

Ndërsa me paragrafin 6 të të njëjtit nen përcaktohet se:

“Paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”.

Bazuar në dispozitat e lartcekura dhe duke shqyrtuar kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, si dhe provat plotësuese të cilat i ka bashkangjitur paditësi pas aktvendimit të gjykatës sipas rekomandimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me Aktvendimin AA.nr.155/2020 të datës 20.02.2020, gjykata vlerësoi se paditësi ka ofruar prova të besueshme të cilat vërtetojnë faktin se ekzekutimi i vendimit do t'i sillte dëm paditësit i cili dëm vështirë do të riparohej. Gjithashtu gjykata gjeti se shtyrja e ekzekutimit të vendimit deri në vendosjen e çështjes në mënyrë meritore, nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar.

Gjykata vlerëson se shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen lidhur me padinë e paditësit, është në interes publik e që shtyrja nuk do t'i sillte dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personave të interesuar. Kjo shmang pasojat e mundshme që do të

shkaktoheshin në të ardhmen, nëse vendimi i kundërshtuar i të paditurës, në fund të procesit gjyqësor, rezulton se është marrë në kundërshtim me ligjin.

Në këtë kuptim gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet nga neni 22 par.6 lidhur me par. 2 të LKA-së, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar, deri në vendosjen përfundimtare të çështjes dhe i cili si i tillë nuk prejudikon mënyrën e vendosjes së çështjes sipas padisë.

Mbi këto arsye, dhe duke u bazuar në nenin 22.7 të LKA, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e aprovuar kërkesën e paditësit-propozuesit.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti për Çështje Administrative

A.nr. 3090/19, me datë 6 prill 2020

Gjyqtarja

Arjeta Sadiku



Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.